

TOMORR PLANGARICA

SËRISH MBI KONCEPTET *FJALI*, *PERIUDHË*, *THËNIE*, *DISKURS*, *TEKST* NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT

Përse riqasje ndaj të njëjtave koncepte në fushën e gjuhësisë e më gjerë?

Përvijimi i dijes gjuhësore në kuadër të zhvillimeve të sotme të shkencave të ligjërimit, ku pjesë përbërëse është edhe e ashtuquajtura *translinguistikë* (që parakupton shqyrtimin e entiteteve gjuhësore përtej fjalisë), e po ashtu edhe vëmendja e shtuar ndaj dukurive gjuhësore në njërën prej formave të përdorimit të gjuhës (në *ligjërimin e folur*), ka nxitur qasje të reja në lidhje me njësitë gjuhësore si *fjalja*, rikonceptime dhe ripërkufizime të saj, por edhe të njësive që përbëjnë a ngjizin entitetet *thënie*, *periudhë*, *diskurs* e *tekst*.

Në aspektin epistemologjik, riqasja ndaj nocioneve të tilla, si *fjali*, *thënie*, *diskurs*, *tekst*, rikuptimësimi i nocioneve të tjera, si *clause*, *propozicion*, *periudhë* etj. janë të motivueshëm, ngaqë dukuritë gjuhësore, të shndërruara në objekte shqyrtimi shkencor, rindërtohen a ripërkufizohen, kur ato janë pikërisht në procesin e shqyrtimit shkencor.

Siç pranohet gjerësisht, tashmë, objekti i njohjes shkencore është një *ndërtim* i aktivitetit shkencor; nëse do të perifrasonim Gaston Bachelard-in, do të theksonim se përgjatë shqyrtimeve tona shkencore, para nesh nuk kemi një botë, një realitet, një dukuri për t'u përshkruar, por për t'u ndërtuar.¹

Ndaj edhe në fushën e gjuhësisë ndodh, hera-herës, që të njëjtat nocione të shenjohen me emërtime të ndryshme, si pasojë e evoluimit të dijes nga epoka në epokë (e bashkë me evoluimin ndryshon edhe qasja ndaj nocionit përkatës), si dhe nevojës për të gjetur termin më të përshtatshëm në lidhje me konceptin që do ta përfaqësojë. Herë të tjera nevoja për një shenjim të ri lind nga përfitimi i një hapësire të re në

¹ Shih G. Bachelard, *La formation de l'esprit scientifique, Contribution à une psychanalyse de la connaissance objective*, Librairie philosophique J. Vrin, 1934 (1967).

zhvillimin e dijes e, për pasojë, edhe i lidhjeve të reja të nocionit brenda asaj dijeje, në raport me nocionet e tjera që përfaqësojnë dukuri që lidhen me njëra-tjetrën.

Por ndodh, po ashtu, që edhe vetë dija gjuhësore të pësojë shndërrime konceptuale, duke parakuptuar qasje të tjera ndaj objektit “gjuhë” dhe njësive që përbëjnë kodin gjuhësor, siç është kalimi prej shqyrtimeve të natyrës gramatikore, në ato të natyrës gjuhësore, prej “gramatikës së fjalisë” në “gramatikën e diskursit” ose “gramatikën e tekstit” (duke sjellë natyrshëm kalimin nga objekti “gjuhë” në “diskurs”, nga *fjalìa* te *thënia* a *teksti*, etj.).

Më drejtpërdrejt, përse riqasje pikërisht ndaj entiteteve *fjali*, *thënie*, *diskurs*, *tekst*?

Qasja dhe riqasja e vijueshme ndaj nocioneve të ndryshme gramatikore e, në rastin tonë, edhe ndaj nocioneve *fjali*, *periudhë*, *thënie*, *tekst* etj., motivohet nga një sërë faktorësh:

- entitete të tilla u referohen *aktualisht* kahjeve jo të njëjta të shqyrtimeve gjuhësore, madje tejet të dallueshme e të veçanta në fushën e gjuhësisë a të shkencave të ligjërimit; për shembull, të gjuhësisë së përfutur nga gramatika gjenerative, që e pranon si njësi e kategori a priori *fjalinë*; a një gjuhësie të proceseve të të thënit (enonciacionit), ku *fjalìa* (entitet abstrakt), përqaset me *thënien* (produkt i një folësi, për një dëgjues);

- nocionet *propozicion*, *fjali* e *thënie*, për shembull, shfaqen jo në të njëjtën kohë në përvojat shqyrtuese të gjuhës/ligjërimit. Siç pohohet tashmë nga studiues të ndryshëm, “nocionet gramatikore janë ndërtuar dhe në një farë mënyre janë të varura prej objektivave të veçanta që kanë orientuar në këtë ose atë epokë përshkrimin e gjuhës” (Combettes, 2011:11). Kategoritë e natyrës gramatikore, mes tyre edhe *fjalìa*, “nuk kanë qenë të përpunuara me synime didaktike, por me një qëllim që do mund ta quanim *filozofik* ose *logjik*. Në zanafillë, nuk flitet për të ndërtuar instrumentet për të siguruar të mësuarin e gjuhëve, por për të ushqyer një refleksion mbi lidhjet që ato arrijnë të vendosin mes ligjërimit dhe realitetit ose mes ligjërimit dhe aspekteve mendore. (...) Nuk duhet të habitemi, pra, nëse konceptet tradicionale të cilat na shfaqen përmes “rinovimesh” nga më të ndryshmet në mënyrë të njëpasnjëshme, janë larg së qeni gjithnjë të përshtatshme për aplikime didaktike” (Combettes, 2011:13). Përvijimi i nocioneve që mbulojnë njësitë sintaksore *proposition* a *fjali* dhe modifikimet kuptimore që pësojnë ato nga epoka në epokë janë, pra, një tregues domethënës

pikërisht i përvojave jo të njëjta që formësohen duke u nisur nga synime teorizuese, logjike, filozofike a logjike, nga njëra anë dhe synimeve didaktike, nga ana tjetër²;

- përvoja të ndryshme studimore, në vende të ndryshme, e kanë zëvendësuar ose jo nocionin “propozicion” me “fjali/frazë”. Në përvojën franceze, edhe pse i zëvendësuar nga nocioni *frazë* (phrase) (në praktikën e mësimdhënies së frëngjishtes, e më tej edhe në ato mirëfilli gjuhësore e teorizuese), *propozicion* vijon të jetë i pranishëm në analizat sintaksore, duke shenjuar marrëdhënie të thjeshtë predikative a një fjali të thjeshtë. Ndërkohë që termi “frazë” (phrase) e ka fituar kuptimin e tij teknik aktual veçse në gjysmën dytë të shekullit XVIII. Më parë ai ka qenë pjesë e leksikut të përgjithshëm, dhe shërbente për të treguar çdo shprehje të përdorur, të përbërë prej shumë fjalësh. Ai ishte atëherë sinonim me ‘mënyrë e të folurit’ ose ‘lokucion’ (locution) (Berrendonner, 2017:4). Ndërsa nuk ka ndodhur e njëjta gjë në traditën angleze, që e ruan “frazë” (phrase) për të treguar çdo grup sintaksor (*nominal phrase*, *verbal phrase* etj.); ndërsa *sentence*, e huazuar prej latinishtes *sententia* tregon grupin sintaksor të veçantë, të njëjtë me atë që e emërtojmë *fjali* (shih më gjerë B. Combettes, 2011:12);

- natyra e qasjeve teorike po ashtu ka ndryshuar. Në lidhje me shkencën e gjuhësisë duhet vënë në dukje se ajo është zgjeruar me një realitet të ri, pra me një *referent* të ri, që ka mundësuar profile të reja të objektit të studimit, të cilat parakuptojnë po ashtu edhe disiplina a dije të ndryshme në hapësirën e *gjuhësisë*, e emërtuar në këtë rast si një *gjuhësi e jashtme*; referentët, që shërbejnë si parakushte për ndërtimin e objektit të

² Siç vëren A. Berrendonner-i “termi proposition në traditën logjike shërben për të treguar një gjykim, domethënë një të menduar që është i aftë që të jetë i vlerësuar si i vërtetë ose i gabuar dhe i formuar nga përvijimi i raportit mes një subjekti dhe një predikati. Në *Gramatikën e përgjithshme e të arsyetuar* (1660:23) të Arnaud & Lancelot theksohet: ‘Gjykimi që bëjmë për gjërat, si në rastin kur unë them *Toka është e rrumbullakët* quhet PROPOSITION; dhe, në këtë mënyrë, çdo propozicion parakupton domosdoshmërisht dy terma: njëri i quajtur *subjekt*, që është ajo gjë për të cilën bëjmë pohimin, si *toka*; dhe tjetri i quajtur *atribut*, që është ajo çka pohojmë, si *e rrumbullakët*’. Nën ndikimin e *Gramatikës së Port-Royal-it*, ky nocion është integruar më së pari në gramatikë, por po aq edhe si mjet i analizës semantike. Pastaj ai është projektuar në sintaksë, i identifikuar në ndërtimet e thjeshta të përbëra prej një foljeje dhe gjymtyrëve të varura prej saj. Prej nga kemi përdorimin e termit *propozicion* për të treguar përbërësit imediatë të frazës komplekse” (Berrendonner, 2017:3).

studimit, janë tashmë të ndryshëm në shqyrtim: nuk studiohen njësi të sistemit, por të përdorimit të gjuhës, me kushtëzime edhe të konteksteve a proceseve të të thënit;

- disiplinat gjuhësore që shqyrtojnë njësitë frastike e përtejfrastike nuk janë vetëm *sintaksa* a *gjuhësia e tekstit*, por dijet përpunohen në një kuadër shumë më të gjerë, me prurje për këto kategori edhe nga *semantika*, më së tepërmi nga “semantika formale” (që merr nxitje prej metodave të logjikës matematikore për të studiuar domethënien e shprehjeve gjuhësore a fjalive) apo *pragmatika* (objekt studimi i së cilës është përdorimi i gjuhës në procesin e komunikimit); këto dy disiplina bashkëplotësuese të njëra-tjetrës, në shumë aspekte mundësojnë të kuptohet se në ç’mënyrë përftohet në komunikim *kuptimi* (sens) i thënieve, duke vënë në lidhje *domethënien* (signification) e fjalive me informacionin bashkëplotësues, që vjen prej përdorimit të fjalive në procesin a situatat e të thënit;

- në fakt, problemet në lidhje me *fjalinë* a *thënien*, *diskursin* a *tekstin* në gjuhën shqipe, siç ndodh edhe në gjuhë të tjera, nuk kanë të bëjnë aq me përkufizimin e këtyre entiteteve, por me *pikëvështrimin* tonë në lidhje me përkufizimet përkatëse. Duhet të kuptojmë në përkufizim atë çka shprehet përmes tij në lidhje me atë dije prej nga përkufizimi është përfutur. Po ashtu edhe termat (madje edhe i njëjti term), nuk parakuptojnë të njëjtën brendi, në varësi të rrymës, shkollës gjuhësore apo edhe epokës në të cilën termi është përdorur. Kështu, siç theksuam më lart, me *propozicion* në antikitet nuk parakuptohej ajo çka kuptojmë tani me këtë term; po ashtu me *propozicion* nuk kuptohet e njëjta gjë në *logjikë*, në *gjuhësi*, në *psikologji* (ose *gjuhësinë kognitive*). E njëjta gjë mund të thuhet në lidhje me konceptin e *thënies* ose të *diskursit*. *Thënia* (énoncé) në pikëvështrimin e teorisë së thëniezimit nuk është e njëjta gjë me thënien në kuptimin e përgjithshëm, që mund të përdoret qoftë edhe në gjuhësi, si formë e folur e një fjalie. E përdorur si term që do të shenjojë produktin e përfutur përgjatë aktit të thëniezimit, *thënia* do të mbushet me brendi shumë më të pasur (në këtë rast si term), në krahasim me “thënien”, si fjali e folur. Po ashtu edhe termi *diskurs* (nga shumë studiues i konsideruar si më polisemiku mes këtyre entiteteve të natyrës ligjërimore) në hapësirën e *analizës së diskursit*, *analizës tekstore të diskursit* ose në atë të *pragmatikës*, mbushet me tjetër brendi në çdonjërin prej këtyre hapësirave shqyrtuese (duke mos qenë thjesht bartës i opozicionit me “gjuhën”, në përqasjen “gjuhë – të folur” të Saussure-it, apo thjesht bartës i përqasjes “rrëfim (récit)-diskurs” që vë në dukje Benveniste-i (shih më gjerë, Carlotti, 2012:27-36)).

Nevoja për riqasje ndaj nocioneve të tilla në kontekstin e studimeve gjuhësore për shqipen e mësimdhënien e saj

Riqasja ndaj nocioneve të tilla na shërben:

- për të qartësuar se nga ç'këndvështrime është bërë shqyrtimi i këtyre entiteteve në përvojat e mendimit gjuhësor europian e shqiptar e, për pasojë, për të parë se në cilat drejtime a kahje mund të nxiten më tej shqyrtimet e sotme;

- për të nxitur e zgjeruar, përmes rivënies në shqyrtim të këtyre nocioneve, pikëvështrimet tona të mëtejshme sipas teorive që kanë mundësuar ndërtimin dhe interpretimin e objekteve të tilla të shqyrtimit ; pra, për të përafruar interesimin ndaj disiplinave të tilla si *pragmatika, gjuhësia e tekstit, analiza e diskursit, teoritë e proceseve të të thënit, etj.*;

- për të formësuar një dije shkencore/savante, që do të mundësojë më tej dijen e didaktizuar, që do të mbështesë parashtrimet e këtyre koncepteve në *gramatikën shkollore* dhe në përgjithësi në mësimdhënien e gjuhës shqipe;

- për të sjellë të pranishme në mendimin gjuhësor shqiptar tërësinë e koncepteve të tjera që përlindin në çdonjërin prej “gramatikave” të përfutuara duke pasur në qendër këtë objekt studimi, si “gramatika e tekstit” dhe “gramatika e diskursit”, krahas “gramatikës së fjalisë”, tërësi konceptesh që përvijojnë një dije që lehtëson analizat shkencore të entiteteve përtejfrazore, si dhe analizat e interpretimet e diskursit e tekstit në praktikën e mësimdhënies së gjuhës e letërsisë në shkollë;

- për t'i krijuar një status të ri studimeve të gjuhës shqipe, për t'i vështuar dukuritë gjuhësore të ligjërit të shkruar, por edhe atij të folur, përmes koncepteve të përvijuara e përpunuara në hapësirat e shkencave të ligjërit, që nuk mjaftohen me studimin e kodit a sistemit gjuhësor, por interesohen në veçanti për dukuritë e shfaqura në procesin përdorimor të gjuhës; që, në këtë mënyrë, përshfaqin të tjera tipare e karakteristika, që parakuptojnë po ashtu nocione, dije, interpretime dhe pikëvështrime të tjera në shqyrtim.

Fjala dhe statusi i saj si njësi sintaksore; a ka vend për mëdyshje?³

Në mendimin tonë gjuhësor është krijuar një përvojë e begatë në shqyrtimin e *fjalisë* si njësi sintaksore. Përgjithësisht janë mbajtur qëndrime që pasqyrojnë teori e kahje interpretimi sipas shkollave e drejtimeve gjuhësore me të cilat studiuesit kanë qenë më të familjarizuar. Në fillimet e shqyrtimeve të kësaj njësie janë të pranishme qasjet a qëndrimet sipas drejtimit logjik të Port-Royal-it (Xanoni, Sheperi, Xhuvani, Rrota, Cipo); më tej përvijohet gjithnjë e më shumë qasja sintaksore, duke e parë fjalinë si shprehëse të mendimit, por edhe të lidhur me komunikimin (Domì, Prifti), pa arritur, gjithsesi, në vështirime mirëfilli strukturaliste, çka u synua dhe u pasqyrua në parashtrimet e *Gramatikës së Akademisë* (2002) nga ekipi hartues; po ashtu është përvijuar një drejtim gjenerativist shqyrtimi (Memushaj, Mita, Koleci e Turano); si dhe enoncativ (Përnaska, Kelmendi); e, më së fundi, rasti i M. Çelikut me *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë), Vështrim i ri teorik* (2012), vepër në të cilën vërehen qëndrime vetjake e përgjithësuese duke u nisur nga përvoja e grumbulluar ndërkohë, por edhe nga analiza e kujdesshme e materialit të ofruar nga shqipja.⁴

Gjithsesi, studimet më intensive në fushën e gjuhësisë së tekstit, të pragmatikës, të analizës së diskursit, për më tepër edhe ato që synojnë studimin e ligjërit të folur (këto të fundit, të mbetura me tepër si projekte të institucioneve tona), po shfaqin dhe do të shfaqin edhe më shumë në të ardhmen ato probleme që janë të pranishme tashmë në përvojat europiane (ku vërehet kjo riqasje, e jo pak herë vërehet edhe prirja për rikuptimësim e specifikim të njësive minimale në lidhje me entitete jo aq të studiuara më parë).

³ Duhet të theksojmë paraprakisht se nuk synojmë të japim përgjigje për shumësinë e problemeve që nxiten e përftohen nga qasjet e riqasjet ndaj entiteteve të sipërpërmendura, por synojmë të lajmojmë për disa prej qëndrimeve kritike në lidhje me këto entitete dhe të nxisim kureshtinë për të njohur e vlerësuar prurjet në shqyrtimin e njësive përbërëse të tyre (ndaj edhe parashtrësja jonë është e pajisur me shumë citime e referenca).

⁴ Për një trajtim të këtyre pikëvështrimeve, shih A. Kananaj, « Fjala përkundrejt thënies dhe propozicionit në analizën sintaksore », SF 2017, 3 :4 (në proces botimi).

Në studimet europiane e më gjerë, me gjithë përkujdesjen e veçantë në shqyrtimin e përkufizimin e kësaj njësie sintaksore,⁵ te studiues të ndryshëm vërehen mëdyshje që nxisin qasje të reja në lidhje me të: ka studiues që e konsiderojnë si të papërshtatshme për studimin e ligjërimit të folur; të tjerë e quajnë të papërshtatshme si njësi minimale në shqyrtimin e tekstit; të tjerë akoma propozojnë koncepte të tjera bashkëplotësuese të saj, të cilat mund të jenë më të përshtatshme, sidomos si njësi minimale a njësi përbërëse të entiteteve diskurs e tekst.

Në fakt, vetë statusi i fjalisë është jo i thjeshtë. Siç vëren A. Berrendonner-i, “fjalia grumbullon (...) praktikisht të dyja statutet epistemologjike: të aksiomës dhe të hipotezës së modelimit. Ajo është njëherazi një ide e pranueshme dhe një ide për t’u provuar. Kjo shpjegon se pse në literaturën gramatikore ka aq shumë tentativa të përkufizimit *a posteriori* (...) dhe padyshim edhe përse krijohen ngecje kur i qasemi këtij nocioni” (Berrendonner:2017:2).

Kalimthi mund të vëmë në dukje se:

- me gjithë mëtimin për ta përcaktuar fjalinë sipas *kritereve* sa më të përshtatshme (kriteri grafik/intonativ, sintaksor, semantik dhe enonciativ), studiuesit vijojnë t’i qasen kësaj njësie edhe nga kritere e pikëvështrime të tjera, duke zbuluar në këtë mënyrë profile të tjera të dukshme, si pasojë e qëndrimeve të tjera teorike ose mëdyshjeve të lindura në procesin e shqyrtimit. Kështu, për shembull, gjuhëtarë të ndryshëm mendojnë që kriteri intonativ, prozodik nuk është shumë i përshtatshëm. Sipas tyre “intonacioni ndikon mbi prurjen informative të fjalisë, më shumë sesa mbi strukturën e saj sintaksore. Për pasojë mbetet e hapur pyetja: a do të konsiderohet i përshtatshëm nocioni i fjalisë për ligjërimin e folur? (shih edhe Carlotti, 2012:20).

- me gjithë prurjet e shumta e të suksesshme të strukturalizmit, sidomos atij amerikan, sipas të cilit “fjalia përfaqëson formën gjuhësore autonome që nuk varet gramatikisht prej asnjë bashkësie tjetër dhe është e vetëmjaftueshme”; ose të gramatikës gjenerative “që e paraqet fjalinë si njësi maksimale të studimit gjuhësor, të përbërë prej një sintagme emërore dhe një sintagme foljore” (Carlotti, 2012:23-24) mbeten, megjithatë, për t’u diskutuar dukuri të tilla si ndërtimet e veçuara, rimarrjet anaforike,

⁵ A. Carlotti thekson : « Fjalia është një koncept i vështirë për t’u përcaktuar. Ries regjistron 150 përkufizime (1921 :1931), Seidel (1935) u shton atyre 80 dhe Hazaël-Massieux (1983) edhe të tjera : është një prej njësive më të diskutuara të gjuhësisë (Carlotti, 2012 :20).

bashkëlidhjet dhe varësitë, kuptimet e përvijuara në sajë të kontekstit në gjuhën e folur etj., të cilat sërish nuk marrin përgjigjen e duhur në qasjet e përvijuara;

- me gjithë prurjet e suksesshme të Shkollës së Pragës (e më tej edhe të përvojave të tjera europiane që vijuan në atë hulli), ku analiza e fjalisë përvijohet në tri plane - morfosintaksor, semantiko-referencial dhe enonciativ-hierarkik⁶ - zgjerimi i pikëvështrimeve në lidhje me fjalinë nxit sërish pyetjen: A është fjalia njësi e gjuhës apo është njësi e diskursit a ligjëritimit të folur? Parashtrimi i kësaj pyetjeje përlind edhe një sërë çështjesh të tjera, që kanë të bëjnë me trajtimin e raporteve fjali-thënie, thënie-diskurs, diskurs-tekst, thënie-tekst, etj.

- me gjithë vëmendjen e përkujdesjen e vijueshme që është treguar në përvojat e ndryshme europiane në shqyrtimin e fjalisë si njësi sintaksore, “përcaktimet dhe procedurat e identifikimit të përpunuara në nivelin e fjalisë nuk funksionojnë më në nivelin e tekstit” (Carlotti, 2012:12); e në këtë kontekst, merr udhë pyetja: cilat do të jenë njësitë përbërëse, minimale a maksimale, të lidhura me entitetet diskurs dhe tekst? A mund të marrë një rol të caktuar fjalia në procesin e analizës së tekstit a diskursit? Me ç’status do të qëndrojë në bashkëmarrëdhëniet e përfutuara mes fjalisë e thënies, thënies e diskursit, thënies e tekstit, fjalisë e tekstit, çdonjëri prej entiteteve?

Mbi statusin e thënies dhe bashkëmarrëdhënien fjali-thënie

Duhet vënë në dukje paraprakisht që çdonjëra nga njësitë a entitetet e mësipërme, krahas marrëdhënies e raporteve me fjalinë, ngërthen edhe një problematikë që ka të bëjë me vetë përfutimin e nocionit përkatës në fushën e dijes prej nga është përfutur, duke bartur në domethëniet e tij gjurmët e teorizimeve të kahjeve përkatëse teorike gjuhësore.

⁶ Analiza në planin morfosintaksor parakupton studimin e sistemit të gjuhës, në të cilin “një fjali është një njësi gjuhësore autonome, e përbërë prej një tërësie fjalësh të ndërtuara sipas rregullave gramatikore përreth një ose shumë produktesh (Vargas, 1995:91); analiza në planin semantiko-referencial parakupton që fjalia është e përfshirë në një botë për të cilën ajo është e jashtme, por për të cilën flet (...), duke pasur të pranishëm një veprues (aktant) dhe një proces ; ndërsa analiza në planin enonciativ-hierarkik parakupton që fjalia është një formësim i përfutur nga një folës në lidhje me ose mbi diçka, e analizueshme në temë dhe remë; me marrjen parasysh të subjektit, fjalia përfiton një dimension pragmatik (shih Carlotti, 2012:25-29).

Kështu, për shembull, në lidhje me *thënien*, vërejmë disa mënyra trajtimi: nga njëra anë, gjuhësia enonciative (kryesisht ajo franceze), e përcakton thënien si prodhim i aktit të enonciacionit⁷; nga ana tjetër, zhvillimi i pragmatikës e përcakton thënien si realizim i veçantë i një fjalie. Për pragmaticienët thënia tregon një fjali në kontekst. Për O. Ducrot-në, thënia është shfaqja e veçantë e fjalisë, realizimi *hic* e *nunc* (këtu e tani) i saj (Ducrot, 1984:95). Sipas Ducrot-së, një fjalie, “entitet abstrakt” mund t’i korrespondojë një pafundësi thëniesh (Ducrot, 1984:177). Sipas tij, “këto dy njësi dalin në pah prej fushave të ndryshme: fjalia është njësi e privilegjuar e gramatikës, ndërsa thënia, si e vëzhgueshme, del në pah prej gjuhësisë”. Për të, “fjalia është njësi teorike e natyrës gramatikore, është “një ndërtim i gjuhëtarit që mundëson të përvijohen thëniet” (1984:177). Ndërsa thënia është shfaqja (occurrence) e veçantë e një fjalie, ndërkohë që enonciacioni është “ngjarja e përfutur nga paraqitja e një thënieje” (1984:178).

Ndërsa për Moeschler-in e Reboul-in, “thënia, domethënë fjalia në përdorim, ka karakteristika të ndryshme prej fjalisë korresponduese; dhe e njëjta fjali, e thënë në rrethana të ndryshme, do t’u korrespondojë thënieve të ndryshme” (cituar nga Carlotti, 2012:32).

Në këtë kontekst shtjellimesh, bashkëmarrëdhënia fjali-thënie shfaqet tejet komplekse. Duket i gjetur pohimi i A. Carlottit, ndërsa thekson se “fjalia dhe thënia janë dy njësi të lidhura. Ndryshimi mes tyre është ndryshim nivelesh: fjalia përvijohet e del në pah prej teorisë (potenciales), ndërsa thënia i përket fushës së të vëzhgueshmes, komunikimit (aktuales). Një dallim semantik mund të përvijohet mes fjalisë ose “njësisë së domethënies” dhe thënies ose “njësisë së kuptimit” (Carlotti, 2012:35-36).⁸

⁷ Në përvojat tona shqyrtuese, trajtime e shpjegime të thukëta në lidhje me thënien e teoritë e proceseve të të thënit kanë bërë sidomos R. Përnaska, T. Kelmendi, R. Ismajli. Shih veçanërisht R. Përnaska, «Gjuhësi ..., ... gjuhësore», Maluka, Tiranë, 2015.

⁸ A. Carlotti thekson se «sipas përdorimit më të përhapur në gjuhësi, kuptimi (sens) i një thënieje ndërtohet duke u nisur prej një fjalie me të cilën lidhet një domethënie (signification) e integruar në një situatë të të thënit (enonciacionit). Ky ndërtim i kuptimit rezulton prej një aktiviteti të *interpretimit*. Ky interpretim rezulton në vetvete prej një induksioni, prej një inference, prej një pune mbi jo të drejtpërdrejtën (impliciten). Asnjë thënie nuk e thotë të gjithën » (Carlotti, 2012 :33).

Mbi statusin e tekstit

Me të njëjtat probleme të brendshme shfaqet edhe nocioni i “tekstit”.

Te Benveniste-i, teksti është produkt i procesit të të thënit (enonciacionit); për Jakobson-in është lëndë e shprehur, e thënë; ndërkohë që J.-M. Adam-i, në kuadër të gjuhësisë tekstore, përjas thënie, si objekt konkret dhe tekstin si objekt abstrakt; e më tej saktëson se ky opozicion është i mbështetur mbi një ndryshim të mënyrës së trajtimit; teksti është një “objekt abstrakt” për gjuhësinë tekstore dhe një “objekt konkret” për analizën tekstore (Adam, 2014:38-43; Carlotti, 2012:29)⁹.

Edhe pse në aspektin receptiv teksti do të përkapet si një vijimësi fjalësh e fjalish, në fakt ai s’mund të reduktohet në një vijimësi fjalësh e fjalish, por ka një organizim përtejfrazor, që s’është thjesht prej pranëvënies së fjalive, por ngaqë përftohen lidhje elementesh gjuhësore edhe përtej asaj pranëvënieje që sigurojnë *kohezionin*. Kjo veçanti ka bërë që të kapërcehet “gramatika e tekstit”, e përftuar sipas modelit të “gramatikës së fjalisë”, për t’u përvijuar “gjuhësia e tekstit” si një “translinguistikë” (shih Carlotti, 2012:36-37, Adam, 1990; 2014:24-30).

Në këtë hapësirë ndihmojnë në studim pikërisht ato nocione që janë përftuar tashmë për të shqyrtuar kohezionin; ato janë të larmishme tashmë si terma : mikro-organizime ose organizime mikrostrukturore, mikro-lidhje, lidhje mikro-sintaksore, lidhje ndërfralore a përtejfralore, propozicione të aktualizuara a thëniezuara etj., të integruara sidomos në makro-sintaksë a sintaksën e presupozimit (shih Adam:2014:84; Carlotti, 2012:37, Neveu, 2017:27-28, 86-87).

Përse disa studiues u drejtohen nocioneve *clause* (sidomos për studimin e ligjërimit të folur) e *propozicion* e *periudhë* për të përcaktuar njësitë tekstore?

Prania e nocioneve dhe metatermave që synojnë të vijnë në ndihmë në studimin e tekstit, sidomos të përfuturit të kohezionit në të, e thekson ‘brishtësinë’ e nocionit fjali për shqyrtimin e dukurive tekstore, duke e lënë atë gjithnjë e më të papërshtatshme si njësi analize për entitetet tekst e diskurs; ndërkohë, në përvojat analizuuese të tekstit e diskursit janë thirrur nocionet e *clause-s*, të *propozicionit*, të *propozicionit të aktualizuar* (*proposition énoncée*), të *enonciacionit*, të *periudhës*, të *aktit diskursiv*, të

⁹ Shih veçanërisht, J.-M. Adam *Les textes: types et prototypes*, Cursus Lettres, Armand Colin, (2011), 3e édition; dhe *La linguistique textuelle*, Cursus, Armand Colin, (2014), 3e édition.

paragrafit, të sekuencës etj. Është pasojë e këtyre pikëvështirimeve dhe e këtyre nocioneve të përpunuara si terma, që ka mundësuar dy hapësira të dallueshme në shqyrtimet e natyrës sintaksore: *mikro-sintaksën* dhe *makro-sintaksën*.¹⁰

Çfarë do të parakuptohet me *clause* në studimet në kuadër të mikro-sintaksës dhe makro-sintaksës?

Clause, që në anglisht shenjon “gjymtyrë të fjalisë”, përbërës të fjalisë ose propozicion (*proposition*) jo në kuptimin logjik, por gramatikor, “është gjendur i përshtatshëm si koncept në studimet narratologjike ose në makro-sintaksë, duke parakuptuar një njësi të përcaktuar më mirë në aspektin formal” (Neveu, 2017:28).

Sipas Alain Berrondonner-it, *clause* përmbush një akt enonciativ të natyrës sintagmatike ose të fjalisë së thjeshtë. Kështu, në shembullin *Megjithë pengesat e hasura, ai vazhdon të vendosur rrugën e tij* (që në qasjen tradicionale do të shihej si një fjali e thjeshtë), do të përlogariten dy *clauses*: *Megjithë pengesat e hasura* (akt i lejimit) dhe *Ai vazhdon të qetë rrugën e tij* (akt i konstatimit/pohimit).

Sipas Franck Neveu-s, do të konsiderohet *clause* çdo njësi sintagmatike ose fjali e thjeshtë (një njësi propozicionale) përbërës e së cilës paraqesin lidhje që mbështeten në kushtëzimet e vargëzimit, të lidhura me njëpasnjshmërinë e diskursit, si dhe në kushtëzimet e reksionit (përshtatjet, bashkimet, etj.), dhe që nuk gjenden të varura në planin morfosintaksor prej një bashkësie më të rëndësishme. Në një diskurs, *clauses-et* e njëpasnjëshme përvijojnë mes tyre raporte semantike të inferencës, dhe jo raporte të varësisë morfosintaksore” (Neveu:2017:28).

¹⁰ ‘*Mikro-sintaksa* është përfutur si pasojë e një qëndrimi kritik të studiuesve në lidhje me fjalinë, e cila rezultonte e papërshtatshme në shqyrtimin e ligjërit të folur, në të cilin nuk mundësohej segmentimin e diskursit nga njëra anë dhe, po ashtu, nuk mundësohej (e mbështetur në treguesit grafikë në gjuhën e shkruar) ndërtimet e gjymtyrëve të veçuara në ligjërimin e shkruar. Për këtë arsye janë përpunuar si më të përshtatshme të tjera teknika të segmentimit të diskursit përmes nocioneve të rivlerësuar të *clause* ose *proposition* (i thëniesuar), si dhe *periudhë*. Ndërsa *makro-sintaksa*, si fushë e gjuhësisë, parakupton shqyrtim të lidhjeve sintaksore përtej kuadrit të fjalisë; parakupton një model të analizës sintaksore, semantike, e po ashtu edhe pragmatike të diskursit që mbështetet në kritikën ndaj nocionit të fjalisë’ (cituar nga Neveu: 2017:86-87).

Edhe J.-M. Adam-i mban një qëndrim të përafërt, por duke përdorur termin *propozicion i aktualizuar* (proposition énoncée - literalisht në shqip do të ishte *propozicion i thëniezuar*) në vend të *clause*.¹¹

Në aspektin metalinguistik, - thekson Adam-i, - kemi nevojë për një njësi minimale që të vërë në dukje a të nxjerrë në pah natyrën e produktit të një akti të thëni (të thënies) dhe t'i shtojë asaj përcaktimin e një mikro-njësie sintaktiko-semantike (koncepti i *propozicionit* e mbulon fare mirë atë). Duke përzgjedhur të flasim për *sifjali të aktualizuar* (proposition énoncée), nuk përkufizojmë një njësi dhe aq virtuale si propozicioni i logjicienëve ose gramatikanëve, por një njësi bazë tekstore, të përfutur në fakt dhe të prodhuar nga një akt i të thënit, pra si një thënie minimale” (Adam, 2014:82).

Sipas disa studiuesve të tjerë (të cilët i përmend edhe F. Neveu), “clause përbën një prag mes dy niveleve sintaksore. Është njësia më e madhe e mikro-sintaksës dhe njësia më e vogël e makro-sintaksës. Bashkësitë e formuara nga këto njësi (të cilat Berrendonner-i i quan “mikro-programe diskursive”) janë quajtur *periudha*.

Kështu, shembulli *Megjithë vështirësitë e hasura, ai vazhdon të qetë rrugën e tij*, do të konsiderohet si një *periudhë*.

Në një tekst, “vargëzimi i periudhave përcakton në vetvete një nivel vargëzimi të natyrës tekstore” (Neveu, 2017:28).

Duke iu referuar Alain Berrendonner-it dhe Marie-José Beguelin-it, që theksojnë se “duke u nisur prej nivelit të *clause*-ës, sintaksa ndryshon natyrë: një tekst nuk duhet të vështrohet si një sekuencë shenjash, por si një bashkësi aktesh ose sjelljesh”, Adam nënvizon: “Dy tipa lidhjesh mes njësive të diskursit janë të dallueshme: një sitaksë e reksionit që shqyrton dukuritë brenda hapësirës së *clause*-it a sifjalisë; dhe një sintaksë e presupozimit mes *clause*-ave a sifjalive që formojnë një periudhë. Duke folur për *morfo-sintaksë* dhe *pragma-sintaksë* për të treguar këta tipa të dallueshëm kombinimi, Berredonner-i e Béguelin-i do ta konsiderojnë *clause*-in njëherazi njësi maksimale të sintaksës së

¹¹ Ne parapëlqejmë të përdorim termin *sifjali e aktualizuar*, për *proposition énoncée* të J.-M. Adam-it. Termi *sifjali* përdoret nga M. Çeliku për fjalinë e thjeshtë; çka e lehtëson në rastin e termit *sifjali e aktualizuar* përdorimin në rastin tonë për të shenjuar njësinë minimale në analizën tekstore; pra në vend të *clause* dhe *proposition énoncée*.

reksionit dhe njësi minimale të sintaksës së presupozimit” (Adam, 2014:84). Edhe për Adam-in, “njësia minimale që quhet *sifjali e aktualizuar* (proposition-énoncée) është produkt i një akti të thëni: ajo është e shprehur nga një thëniepërfutues i pandashëm prej një bashkëthënësi (co-énonciateur) (Adam, 2014:84).

Rikuptimësimi i nocionit *periudhë*

Del i nevojshëm në këtë kontekst edhe rikuptimësimi i nocionit “periudhë”.

Franck Neveu nënvizon: “... në retorikë, periudha do të ishte një tip i përvijuar i fjalisë komplekse, që formon një njësi sintaksore të kuptimshme, përgjatë një frymënxjerrjeje ... duke përfutur një efekt melodik” (Neveu, 2017:160). (Ndërsa në përvojat tona ajo është përdorur dhe përdoret rëndom si e njëjtë me fjalinë e përbërë).

Por në makro-sintaksë (sidomos në punimet e Alain Berrendonner-it) “periudha është përcaktuar si një njësi informuese që rigrupon segmente diskursive të quajtura *clauses* a sifjali, që përvijojnë mes tyre lidhje të presupozimit ose më përgjithësisht të inferencës. Është konsideruar, pra, si periudhë çdo sekuencë diskursive, segmentet e së cilës hyjnë në lidhje veçse me ndërmjetësimin e dijeve të përbashkëta mes thëniepërfutuesit dhe bashkëthënësit” (Neveu 2017:100).

Kapërcehet përmes kësaj mënyre segmentimi edhe ngërçi i përfutur në lidhje me gjymtyrët e veçuara. Nga ky këndvështrim, thënia *Ah, fëmijët, duhet delikatesë*, do të përbëhet nga një periudhë dypjesëshe/binare, e formuar nga dy clauses a sifjali të aktualizuara, të cilat nuk kanë mes tyre lidhje morfosintaksore, por që formësojnë këtë njësi të diskursit (periudhën), rezultat i një marrëdhënieje a raporti veçse semantik dhe jo të drejtpërdrejtë.

Për të ndërtuar kuptimin e thënies do të duhet të vendoset një lidhje mes dijeve enciklopedike të thëniepërfutuesit dhe thëniemarrësit, në mënyrë që domethëniet e sifjalisë së dytë të aktualizuar të pohojnë diçka për sifjalinë e parë të aktualizuar; e në këtë mënyrë të përfutet kuptimi i gjithë thënies a periudhës.

J.-M. Adam-i sjell këtë kontekst që ka mundësuar rikonceptualizimin e periudhës: “I teorizuar nga gramatikanët dhe stilisticienët klasikë, nocioni i periudhës është rishfaqur në gjuhësinë e viteve 1980 në penën e specialistëve të gjuhës së folur (Daniel Luzatti 1985, Claire Blanche-Benveniste 1987, Alain Berrendonner 2002). Para papërshtatshmërisë së nocionit të fjalisë në ligjërimin e folur, këta të fundit

kanë pasur nevojë për të përcaktuar blloqe njësish që përvijojnë mes tyre lidhje hierarkike të varësisë morfosintaksore të dallueshme. Për këtë arsye, A. Berrendonner-i i qaset nocionit të periudhës, të cilin e përcakton si bashkim minimal të dy clauses –ve (2002). Në fushën e gjuhësisë tekstore, Michel Charoles (1988) ka qenë i pari që e ka konsideruar periudhën si një prej planeve të organizimit të tekstualitetit” (Adam, 2014:164). Për Adam-in, për të përcaktuar “bashkimin” pak a shumë kompleks të thënieve që hyjnë në përbërjen a kompozicionin tekstor, “koncepti i periudhës paraqet përparësinë e mbulimit të lidhjeve sa logjiko-gramatikore, po aq edhe ritmike”. Sipas tij, riaktivizimi i këtij koncepti në gjuhësinë e tekstit të shkruar është një rast për të vënë në dukje që ka oralitet në të shkruar” (Adam, 2014:83).

Në mbyllje

Qasjet dhe riqasjet ndaj entiteteve të tilla si *fjalìa, periudha, thënia, diskursi* a *teksti* janë të motivueshme, sepse këto riqasje jo vetëm na mundësojnë të ndriçojmë më mirë atë çka është përvijuar tashmë si përvojë e suksesshme në shqyrtimet gjuhësore, por na mundësojnë të rindërtojmë profile të reja të objekteve tona të studimit, duke na detyruar njëherazi të zgjerojmë edhe hapësirat e interpretimeve tona teorike; e, në këtë mënyrë, të rikonceptualizojmë kategoritë e entitetet gjuhësore për të cilat përkujdeset në mënyrë të veçantë mendimi i sotëm gjuhësor. Fjalìa, thënia, diskursi dhe teksti kanë fituar një status të veçantë në këto shqyrtime, duke e parakuptuar tejte të motivueshme edhe këtë qasje a riqasje shkencore.

BIBLIOGRAFI

- Adam, J.-M. (2011), *Les textes: types et prototypes*, Cursus Lettres, Armand Colin, 3e édition.
- Adam, J.-M. (2014), *La linguistique textuelle*, Cursus, Armand Colin, 3e édition.
- Berrendonner, A. (1993), *La phrase et les articulations du discours*, Le français dans le monde, Numéro spécial, février-mars 1993.
- Berrendonner, A. (2017), *La notion de phrase*, in Encyclopédie Grammaticale du Français, en ligne: <http://encyclogram.fr>.
- Carlotti, A. (2012), *Phrase, énoncé, texte, discours; De la linguistique universitaire à la grammaire scolaire*, Lambert-Lucas, Limoges.

- Combettes, B. (2000), *Phrase, texte, discours; quels cadres pour l'étude de la langue*, Pratiques, nr. 97-98, p. 221-228.
- Combettes, B. (2011), *Phrase et proposition. Histoire et évolution de deux notions grammaticales*, Le français aujourd'hui, 2011/2, nr. 173, pp. 11-20.
- Ducrot, O. (1984), *Le Dire et le Dit*, Paris, Minuit.
- Garde-Tamine, J. (2003), *Phrase, proposition, énoncé...*, *Pour une nouvelle terminologie*, in *L'information grammaticale*, Année 2003, pp. 23-27.
- Neveu, F. (2017), *Lexique des notions linguistique*, Armand Colin, 3e édition.
- Soutet, O. (2011), *Linguistique*, PUF.

